



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



01nr 353601-32119
Dt: 23.06.2025

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, duke vepruar konform dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenit 12 të Kontratës me numër 01-011/01-8186, me datën 23.06.2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Shkëputet Kontrata për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës komunale – byfese në SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë e evidentuar me numër kadastral të ngastrës: P-70705037-00293-1 në sipërfaqe prej 12.00 m², e lidhur ndërmjet Komunës së Gjakovës dhe Fëllanza Lluhani nga Gjakova, me numër 01-011/01-8186, datës 08.11.2022.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Komuna e Gjakovës dhe znj. Fëllanza Lluhani nga Gjakova kanë lidhur Kontratë me numër 01-011/01-8186, për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës komunale – byfese në SHMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë e evidentuar me numër kadastral të ngastrës: P-70705037-00293-1 në sipërfaqe prej 12.00 m², me kohëzgjatje nga data 08.11.2022 deri me datë 08.11.2027.

Nga njësia përgjegjëse përkatësisht nga menaxhmenti i shkollës ku gjendet byfeja, si dhe nga Drejtoria e Arsimit është nxjerrë raport zyrtar me të cilin është vërtetuar dhe konstatuar se shfrytëzuesja nuk ka respektuar dispozitat e kontratës. Rrjedhimisht, që nga paraqitja e rastit për “ngacmim seksual i nxënëses së shkollës”, nuk ka funksionuar byfeja deri në marrjen e këtij vendimi, po ashtu shfrytëzuesja nuk ka përfunduar obligime financiare në vlerë prej 2,050.00€ për shfrytëzimin e pronës komunale sipas kontratës.

Andaj, nga të lartcekurat si dhe në mbështetje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, Rregullores (Qrk) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe nenit 12 të Kontratës me numër 01-011/01-8186, datës 08.11.2022, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ me padi në Gjykatën kompetente, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtit.

Vendimi i dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit të Komunës
- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Drejtorisë së Arsimit
- Sektorit për Menaxhimin e Pronës Komunale
- Palës
- Arkivit.

Ardian Gjini


Kryetar i Komunës së Gjakovës





REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË/A:	17.06.2025
REFERENCË/NR:	04-188
PËR/ZA/TO:	Ardian Gjini – Kryetar në Komunën e Gjakovës
CC:	Spektori Ligjor
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Drejtoria për Arsim në Gjakovë
NGA/OD/FROM:	Eranda Baçi, Drejtor në Drejtorinë e Arsimit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	Kërkesë për mbyllje të bufës në SHMU "Mazllum Këpuska"



I nderuar,

Drejtoria e Arsimit, bazuar në Raportin me nr. protokolli 37/2025, të datës 25.04.2025 nga SHMU "Mazllum Këpuska", sipas të cilit nga Komuna e Gjakovës i është dhënë në shfrytëzim afatshkurtër shfrytëzuesit "Fëllënza Lluhani B.I." prona komunale, e cila gjendet në oborrin e shkollës (ka rruga e Çabratit) me Kontratën e dt. 08.11.2022 për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të Pronës Komunale – Bufesë në SHMU "Mazllum Këpuska" në Gjakovë.

Sipas këtij raporti bufeja ka funksionuar mirë dhe në bufe janë ushqyer nxënësit. Gjatë kohës kur është bërë renovimi i shkollës (Mars - Qershor 2024), konkretisht realizimi i projektit për Efijencë, bufeja ka funksionuar me pengesa pasi që oborri ka qenë i bllokuar për shkak të punimeve. Nga ana tjetër ka pasur edhe raste kur nuk është hapur, e për çka menaxhmenti i shkollës nuk është njoftuar me arsyen. Po ashtu, ju njoftojmë se nga rasti i paraqitur për ngacmim seksual i nxënësës të shkollës nga Dren Lluhani (vëlla i pronares së bufës Fëllënza Lluhani), e që i njëjti është prononcuar dhe i ditur edhe përmes mediave, kjo bufe nuk është duke funksionuar dhe se ka borxhe të pa paguara për 10 (dhjetë) muaj nga 205.00 €, me gjithsejtë shumën 2.050.00 €.

Prandaj, Drejtoria e Arsimit propozon që bazuar në arsyet e cekura si më lartë të merret vendim për shkëputje të njëanshme të kontratës me shfrytëzuesin e pronës komunale "Fëllënza Lluhani B.I."

Bashkëngjitur:

- Raporti nga SHMU "Mazllum Këpuska" me nr. protokolli 37/2025, i dt.25.04.2025
- Borxhet nga qiraja shfrytëzuesit "Fëllënza B.I." të nxjerra nga financierja e DKA-së, dt. 17.06.2025

Me respekt !



SHMU "Mazllum Këpuska"
Nr. prot. 37/2025
Datë: 25. 4. 2025
Gjakovë

Drejtoria Komunal e Arsimit
zgj. Eranda Baçi

Raport mbi byfenë që ndodhet në oborr të SHMU "Mazllum Këpuska"

Prora komunale e cila gjendet në oborr (kafë rruga e Çabranit), është dhënë për shfrytëzim atatshkurtër nga KK Gjakovë dhe për këtë kështë është nënshkruar edhe kontratë me shfrytëzuesin.

Vendimi 01 Nr 011/01-8186 i datës 08. 11. 2022 ka hyrë në fuqi me nënshkrimin e dy paleve.

Nga nënshkrimi i marrëveshjes, bufeja ka filluar së funksionuar dhe në byfe janë ushqyer nxënësit e shkollës.

Kryesisht dhe në shumicën e ditëve byfeja ka qenë e hapur, por ka pasur edhe raste kur nuk është hapur. Në këto raste menaxhmenti i shkollës, nuk ka pasur ndonjë njoftim për arsyen.

Gjatë kohës kur në shkollën tonë është bërë renovimi i shkollës (mars – qershor 2024), konkretisht realizimi i Projektit për Eficiençë, byfeja ka funksionuar me pengesa pasi që oborri ka qenë i bllokuar për shkak të punimeve. Megjithatë furnizimi i nxënësve me ushqim është bërë rregullisht dhe sipas kërkesave dhe mundësive të nxënësve.

Nga data 27 mars 2025, byfeja është e mbyllur.

Për raport financiar, ne kemi raportuar në Drejtori Komunale të Arsimit.

Ky raport është bërë pas kërkesës verbale nga ana juaj.

Me respekt!

Arbënor Pozhegu

Drejtor i SHMU Mazllum Këpuska - Gjakovë



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



DATË/A:	17.06.2025
REFERENC-Ë:	04-zyrtare
PËR/ZA/TO:	z. Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
CC:	Zyrës Ligjore
NGA/OD/FROM:	z. Eranda Baçi Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Komuna Gjakovë
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT	<i>Borxhet nga qiraja e shmu "Mazllom Këpuska"</i>



Të nderuar,

Ju njoftojmë se kontrata me nr 01/463/02/25416 me titull " Dhënia për shfrytëzimin afatshkurtër të pronës komunale – bufësë së shkollës Mazllom Këpuska" Gjakovë ku shfrytëzuesja është " Fëllanza Lluhani B.I." ka borxhe te papaguara për 10 muaj nga 205.00 € me gjithsejtë shumën 2.050.00 €.

KOMUNA E GJAKOVËS
DREJTORIA E ARSIMIT
Postal address: Nëna Terezë Gjakovë, Kosovë
Tel: 0380200 44 006
<http://kk.rks-gov.net/gjakove>